



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 21.01.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Jelena Bontiç, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Mufera Sinik.

Në mbledhje morën pjesë: zyrtarë nga presidenca, përfaqësues të OSBE-së, KDI-së dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me 23 dhe 26.12.2014;
3. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së MKRS-së.
- I ftuar Z. Kujtim Shala, ministër.
4. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me 23 dhe 26.12.2014;**
Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura u miratuan pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së MKRS-së. **- I ftuar Z. Kujtim Shala, ministër.**

Nait Hasani, kryesuesi i mbledhjes, theksoi se për takimin e sotëm kemi ftuar zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, me qëllim të diskutimit për prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie. Ndërsa ne programin legjislativ në bashkëpunim me ministrinë të bëhet harmonizimi i datave për procedim të projektligjeve nga ana e ministrisë.

Ministri, Kujtim Shala, në fillim theksoi se Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit si prioritet do ta ketë rritjen e buxhetit për Institucionet e kulturës dhe sportit, Bibliotekën Kombëtare, Teatrin Kombëtar, Qendrën Kinematografike të Kosovës, Filharmoninë e Kosovës, Baletin e Kosovës, Ansamblin "Shota etj.

Ai tha se për të përmbushur këto qëllime, kanë nisur edhe procedurat për krijimin e Kodeve Buxhetore të këtyre Institucioneve. Ministria do t' i kushtojë një rëndësi të veçantë edhe mbështetjes së botuesve të librit, teatrove dhe bibliotekave të qyteteve. Prioritet i Ministrisë, do të jetë hartimi i ligjeve të fushave përkatëse, si dhe hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Kulturën, pastaj Strategjisë për Trashëgiminë Kulturore , Ligji për Sponzorime dhe Donacione, Ligji për Trashëgiminë, pastaj i dokumenteve të rëndësishme që mundësojnë zhvillimin e jetës kulturore në vend dhe prezantimin veprimtarive në suaza ndërkombëtare, si dhe ngritjen e objekteve nga lëmi i kulturës dhe sportit. Sa i përket ndërtimit të objekteve të institucioneve kulturore e sportive, ministri tha se pas problemeve në projektin e mëhershëm të teatrit të operas dhe baletit "Ibrahim Rugova", Qeveria e Republikës së Kosovës do të shpallë konkurs të ri ndërkombëtar për projektimin dhe më pas ndërtimin e saj.

Ministria do të bëjë projektin për ndërtimin e Muzeut të Arteve Bashkëkohore në Prishtinë, pastaj rinovimin e Teatrit Kombëtar, të Bibliotekës Kombëtare, si dhe të objekteve kulturore në disa qendra, ndërsa miratimi i Ligjit për Muzetë do të krijojë bazë ligjore edhe për themelimin e muzeve të tjerë.

Një objektiv i rëndësishëm i Qeverisë do të jetë edhe subvencionimi i punës së organizatave të rinjve, përkatësisht veprimtarive të tyre. Një vëmendje e veçantë do t' i kushtohet edhe ndërtimit të infrastrukturës sportive, sidomos të atyre që do të krijojnë kushte për gara ndërkombëtare, siç do të jenë stadiumet në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Në kuadër të përgatitjeve për ndërtimin e stadiumit nacional të Futbollit në Prishtinë, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës kanë filluar procedurat për ndarjen e lokacionit. Është në plan edhe ndërtimi i Pallatit Olimpik, në të cilin do të ketë selinë Komiteti Olimpik i Kosovës , Komiteti Paraolimpik, si dhe 30 Federata.

Gjithashtu parashihet edhe ndërtimi i disa palestrave sportive në disa qendra komunale, si dhe i stadiumeve ndihmëse. Pranimi i Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar do të zgjerojë mundësitë për sportistët kosovarë, theksoi ministri Shala.

Salih Morina thesoi se iniciativa për kode të veçanta buxhetore për institucionet e kulturës është një iniciativë e mirëpritur, ai ngriti çështjen edhe të Këshillit të Kosovës për Trashegimi Kulturore i cili nuk funksionon nga viti 2010.

Bekim Haxhiu në diskutimin e tij përmendi Rekomandimet e nxjerra nga Kuvendi, të cilat rekomandime kanë dalë si rezultat i debatit parlamentar për sportin në Kuvendin e Kosovës dhe si të tilla janë përfshirë në Programin legjislativ të Qeverisë.

Me tej kërkoi nga ministri të hartoi një Strategji për masovizimin e sportit shkollor, si dhe të ndermerren masa në përfundimin e punimeve të Stadiumeve Olimpikë të Prishtinës dhe atë Adem Jashari të Mitrovicës, në mënyrë që të krijohen kushte për zhvillimin veprimtarive sportive edhe në relacione ndërkombëtare.

Shpejtim Bulliqi tha se investimet në lëmin e kulturës dhe sportit, ngritja e objekteve si muzetë, teatri i operas dhe baletit janë plane ambicioze që do të krijojnë kushte për zhvillimin të këtyre veprimtarive, ai kerkoi nga ministri të tejkalohen lëshimet e deritashme sa i përket këtyre çështjeve.

Ismail Kurteshi kerkoi nga ministri që kjo ministri të kushtojë rëndësi edukimit jo formal me projekte të ndryshme për fëmijë, si dhe të funksionojë bashkëpunimi me drejtoritë komunale të rinisë me qëllim që të rinjtë të angazhohen sa më shumë në sport.

Teuta Haxhiu në diskutimin e saj, tha se ministria duhet të angazhohet rreth objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe të ketë përgjegjësi për objekte të cilat janë në mbrojtje siq është rasti me objektin e trashëgimisë në fshatin Dobrosh. Ajo ngrii edhe çështjen e Teatrove të qyteteve si dhe të Këshillit të Kosovës për Trashegimi Kulturore, dhe me këtë rast kërkoi nga ministri të procedoi projektligjin për Trashegimi Kulturore.

Shukrije Bytyqi në diskutimin e saj kërkoi nga ministri që të hartohet një broshurë e cila do të shpërndahej nëpër komuna me qëllim që të njoftohen të rinjtë me të arriturat e sportit dhe kulturës në përgjithësi.

Jelena Bontiç në diskutimin e saj kërkoi nga ministri që të ndahet një kod buxhetor për investim në infrastrukturë sportive në Komunën e Shtërpces pasi që rinia nga kjo komunë konsiderohet si multietnike, dhe investimi në sport është më se i nevojshëm.

4. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit u njoftuan lidhur me organizimin e një punëtorie nga OSBE lidhur me hartimin e planit të punës së Komisionit e cila planifikohet të mbahet më 27 janar 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani